

RELACION TEKNIK:


NDËRTIM RRJET UJËSJELLËSI NË RRUGËT :“BILAL XHAFERI, PJETER BUDI, XHEMAL KABA , XHELADIN BEQIRI, PRENGAJ,VINÇENS PRENUSHI, VOJO KUSHI, SADO KOSHENO , XHEMAL DERVISHI, KONFERENCA E MUKJES, MITAT FRASHERI DHE NAIM FRASHERI,THEMISTOKLI GERMANJI ” , BABRU-TIRANË.

1. Qëllimi

Ky projekt zbatimi konsiston në heqjen e kolektoreve, të ndërtuara në tubacionet DN-700mm dhe DN-1000mm çelik, në zonën e Babrusë. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në rrugët :“Bilal Xhaferi, Pjeter Budi, Xhemal Kaba , Xheladin Beqiri, Prengaj,Vinçens Prenushi, Vojo Kushi, SadoKosheno , Xhemal Dervishi, Konferenca e Mukjes, Mitat Frasheri dhe Naim Frasheri ” , Babru-Tiranë,do të realizojë një furnizim normal me ujë të zonës së banuar, si dhe do të eliminojë humbjet në rrjetin ekzistues.

2. Vendndodhja

Vendodhja e këtij objekti gjendet kryesisht ne zonen e perkatesisht zona e Babroit, Paskuqan, Bashkia Kamëz. Kjo zone sipas imazhit te meposhtem :





Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 08004488
info@ukt.al
NIPT L72320033P

3. Gjendja ekzistuese

Zona e cila është objekt i projektit furnizohet me uje nga kolektoret e ndertuar ne tubacionet DN-700,1000mm çelik

Kolektoret te ndertuar ne periudha te ndryshme, jane shfrytezuar ne mungese te nje infrastrukture te plote furnizimit me uje, me qellim plotesimin e nevojave te nje zone te banuar mjaft te gjere e cila ka qene objekt ndryshimesh te shpejta demografike. Tubacionet e shfrytezuar me qellim furnizimin me uje jane :

-Tubacioni DN-1000mm i cili furnizon nga Impianti Boville depon e Kinostudios e cila me pas shperndahet rreth Kinostudios e me tej


- Tubacionin DN-700mm i cili furnizon nga burimet e Bovilles se Vjeter depon e Kinostudios

Pra kolektoret jane ndertuar ne disa prej tubacioneve me te rendesishem qe furnizojne me uje qytetin e Tiranës, duke percjelle sasi te konsiderueshme prurjeje. Per shkak te abuzimeve neper kolektore dhe jo vetem, pamvaresisht permiresimit ne prerjen e lidhjeve te paligjshme, ka ndodhur qe te shfaqen problematika ne furnizimin me uje te qytetit.

Gjendja e kolektoreve sote eshte ende jo e mire ku si probleme mund te permendim :

- Lidhjet shfaqin rrjedhje te vazhdueshme
- Kolektoret jane te ndertuar ne anesoret e rrugeve pa kurrfare mbrojtje nga agjentet e jashtem
- Pusetat ne ato raste kur jane ndertuar, jane te demtuara ose te permbytura

Vendodhja e kolektoreve si me poshte :



Zona e cila është objekt i projektit është pjesë e Bashkisë Kamëz. Në kuadër të marrëveshjes Prot 17169 Dt 05.08.2018, Prot 3691 Dt 05.07.2018 ku përcaktohet kalimi i rrjeteve të ujësjellësit në varësi të Bashkisë Kamëz, është parashikuar hartimi i një projekti me qëllim plotësimin e të gjithë zonës me rrjet shpërndarës ujësjellësi.

Ky projekt është gjithashtu vijësi e disa projekteve mjaft strategjike që U.K.T ka hartuar ose në proces zbatimi aktualisht. Përkishtë përmendim projektet : "Ndërtim linja transmetimi ujësjellësi nga Impjanti i Bovilles deri në Depo 4000m³ të Yzberishtit dhe për furnizimin e Depos së Koder Kamzës" dhe projekti "HARTIM I PROJEKT-PREVENTIVIT TË ZBATIMIT PËR SOT DHE PRESPEKTIVEN 25 VJEÇARE TË FURNIZIMIT ME UJË TË ZONAVE: KOMBINAT, QYTETI NXENESVE (SELITE E VOGEL), YZBERISHTIT, KATUND I RI (MEZES, KASHAR, AUTOSTRADË), KODER KAMEZ" gjithashtu edhe projekti "Shtesa e Impiantit Boville, faza e I-re me 600 l/sek"

4. Relievi topografik i zonës

Rilevimi topografik i objekteve për hartimin e këtij projekt zbatimi është bërë duke u mbështetur në dokumentet e arshivës së Sektorit të Projektimit të sh.a.U.K.T. si dhe matje topografike të bëra në terren.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 08004488
info@ukt.al
NIPT L72320033P

5. Llogaritjet Hidraulike

Llogaritjet hidraulike me qëllim dimensionim e rrjetit shpërndarës të ujësjellësit janë realizuar duke u nisur nga të dhënat e detyrës së projektimit dhe sipas normave të furnizimit me ujë për zonën e fshatit :

- Numri i familjeve në zonën e projektit = 3500 banorë
- Dendësia e popullsisë $d = 67.3$ banorë/ha
- Humbjet në rrjet 20%
- Norma e furnizimit me ujë për popullsinë $n = 200 \text{ l}/(\text{ba} \cdot \text{ditë})$
- Koeficienti i pikut = 2
- Oret e furnizimit me ujë = 24
- Jetëgjatësia e veprës $t = 20$ vjet
- Norma e rritjes së popullsisë $r = 1.6\%$

Numri i popullsisë për $t = 25$ vjet :

$$N_2 = N_1 \cdot (1 + r)^t = 3500 \cdot (1 + 0.016)^{25} = 5200 \text{ banorë}$$

Llogarisim prurjet karakteristike

$$Q_{\max}^{\text{ditore}} = \frac{N_2 \cdot n}{1000} = \frac{5200 \cdot (200 + 20\% \cdot 200)}{1000} = 1248 \text{ m}^3/\text{ditë}$$

$$Q_{\text{mes}}^{\text{orare}} = \frac{Q_{\max}^{\text{dit}}}{24} = \frac{1248}{24} = 52 \text{ m}^3/\text{orë}$$

$$Q_{\max}^{\text{orare}} = Q_{\text{mes}}^{\text{orare}} \cdot K = 52 \cdot 2 = 104 \text{ m}^3/\text{orë}$$

$$q_{\max}^{\text{sek}} = \frac{Q_{\max}^{\text{orare}}}{3600} = \frac{104 \cdot 1000}{3600} = 28.88 \text{ l}/\text{sek}$$

Skema e zgjedhur për furnizimin me ujë, është realizuar duke shfrytëzuar rrugët ekzistuese. Skemat e furnizimit me ujë janë 4, dhe si burim furnizimi me ujë është shfrytëzuar tubacioni DN-700mm, DN-1000mm çelik.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 08004488
info@ukt.al
NIPT L72320033P

Llogaritjet vazhdojnë me percaktimin e diametrave fillestrar, duke ruajtur kushtin e shpejtesise ekonomike te ujit ne tubacion :

$$\begin{cases} v_{\min} = (0.7 \div 0.9) \text{m/sek} \\ v_{\max} = (1.34 \div 2.68) \text{m/sek} \end{cases}$$

Furnizimi me ujë i zonës do të realizohet me tub Pe100Pn10Dj-90mm dhe do të shpërndahej në rrugicat përkatëse me tubacione të diametrave të ndryshëm percaktuar ne planimetritë përkatëse të paraqitura në projekt.

Furnizimi me ujë i objekteve do të realizohet me tub PeDj-20,25,32mm ku do të vëndosen kasetat me rakorderitë përkatëse për vëndosjen e matësit të ujit me qëllim faturimin e konsumimit të ujit të pijshëm duke eleminuar shpërdorimin e ujit në këtë zonë

Projektues

Ing. Bukurie DEMIRAJ

Ing.Anisa Zaka

Ing.Erald Hallidri

Ing.Endri Piero

Pergj./Sektori i Projektimit

Ing.Albana MILO